



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I SPORTEVE TË TIRANËS
SENATI AKADEMIK

Nr. 641/4 Prot.

Tiranë, 21.04.2022

VENDIM

Nr. 40, Datë 21.042022

**“PËR MIRATIMIN E RREGULLORES SË KOMISIONEVE TË PËRHERSHME PËR
DHËNIEN E GRADËS SHKENCORE “DOKTOR” DHE MANUALEVE PËR
PROCEDURAT PËR APLIKIMIN DHE PRANIMIN NË CIKLIN E TRETË TË
STUDIMEVE TË DOKTORATURËS NË UST”**

Në mbështetje të nenit 38, pika 1, gërma “d” të ligjit nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”, nenit 20 gërma “ë” të Statutit të UST-së, Senati Akademik në mbledhjen e datës 21.04.2022

VENDOSI

1. Miratimin e Rregullores së Komisioneve të Përhershme për dhënie të gradës shkencore “Doktor” dhe Manualit për procedurat për aplikimin dhe pranimin në ciklin e tretë të studimeve të doktoraturave pranë Fakultetit të Veprimtarisë Fizike dhe Rekreacionit dhe Fakultetit të Shkencave të Lëvizjes (bashkëlidhur).
2. Ky Vendim i përcillet për zbatim Fakultetit të Veprimtarisë Fizike dhe Rekreacionit, Fakultetit të Shkencave të Lëvizjes, si dhe Drejtorisë së Zhvillimit të Programeve dhe Dixhitalizimit të Shërbimeve Akademike Shkencore për publikimin në faqen zyrtare të UST.
3. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I SENATIT AKADEMIK
Prof. Dr. AGRON KASA





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I SPORTEVE TË TIRANËS
SENATI AKADEMIK

RREGULLORE
E
KOMISIONEVE TË PËRHERSHME TË
DHËNIES SË
GRADËS SHKENCORE “DOKTOR” NË
UST

MIRATOHET

Prof.Dr. Agron KASA
Kryetari i Senatit Akademik të UST

Miratuar me Vendim Nr. _____, datë _____.2022
të Senatit Akademik të Universitetit të Sporteve të Tiranës
PËRMBAJTJE

1. Rregullorja e Komisionit të Përhershëm për dhënien e gradës shkencore “Doktor” në UST mbështetet në legjislacionin e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë dhe në Statutin e Universitetit të Sporteve të Tiranës (UST).
 2. Komisioni i përhershëm për dhënien e gradës shkencore “Doktor” në UST mban emërtimin **“Komisioni i Doktoratës”**.
 3. Komisioni Doktorates pranë njësisë kryesore të UST, ngrihet në zbatim të legjislacionit për Arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë, në Statutin e Universitetit të Sporteve të Tiranës, në Rregulloren e Studimeve të Ciklit të tretë dhe në Rregulloret e Programeve të Studimit të Doktoraturës.
 4. Numri i anëtarëve të Komisionit të Doktorates në UST është pesë. Ata janë personel akademik me kohë të plotë që i perkasin kategorisë “Profesor”.
 5. Komisioni i Doktoraturës monitoron gjithë procesin e fitimit të gradës shkencore “Doktor” të kandidatëve të njësisë kryesore, pranë së cilës ai funksionon , ku përfshihen vlersimi dhe renditja e kandidateve në pranim, ecuria e fazave të studimit dhe vleresimi përfundimtar për dhënien e gradës shkencore “Doktor”.
1. Komisioni i Doktorates mbledhet kur janë të pranishëm jo më pak se 4 anëtarë të tij.
 2. Vendimet merren me shumicë të thjeshtë të votave të të gjithë anëtarëve të tij, me përjashtim të rasteve kur specifikohet ndryshe në këtë rregullore ose kur KD merr një vendim të posaçëm. Nuk lejohet abstenimi. Në rastet e paritetit në votim, vota e kryetarit është dominante.
 3. Nëse anëtari i KD ka konflikt interesi me çështjen që vlerësohet , anëtari terhiqet nga diskutimi dhe vendim-marrja përkatëse.
 4. Komisioni i Doktoratës miraton fushat e studimeve doktorale të njësisë bazë mbi bazën e propozimeve të tyre dhe ia përcjell ato për informim Senatit, kur ndryshimi i atyre fushave nuk është më i madh se 70% i fushave ekzistuese për një periudhë tre vjeçare.
 5. Kur fushat e studimeve doktorale ndryshohen për më shumë se 70% të atyre ekzistuese, atëherë ato miratohen paraprakisht prej Komisionit të Doktoratës dhe më pas i përcillen Senatit Akademik të UST-së për vijimin e miratimit të tyre përfundimtar në përputhje me legjislacionin për Arsimin e Lartë në fuqi.

6. Miratimi i fushave të studimeve doktorale bëhet me shumicë të cilësuar: katër nga pesë anëtarë të Komisionit të Doktoratës.
7. Komisioni i Doktoratës shqyrton dosjen e çdo kandidati që i paraqet njësisia bazë pranë së cilës ai do të kryejë studimet doktorale. KD cakton të paktën një relator për shqyrtimin e dosjes dhe thërret në dëgjese shpjeguese kandidatin së bashku me udhëheqësin shkencor. Mbështetur në raportin e lëshuar (nga relatori/ët) si dhe në gjykimin e anëtarëve të tij, komisioni miraton ose jo propozimin e njësisë bazë për kandidatin dhe udhëheqësin e tij.
8. Komisioni i Doktorates miraton përbërjen e jurisë së mbrojtjes së doktoraturës mbi propozimin e njësisë bazë dhe ia përcjell atë drejtuesit të njësisë kryesore të UST-së.
9. Komisioni i Doktoraturës pas mbrojtjes së doktoratës dhe vlerësimit të jurisë merr vendimin për dhënien ose jo të gradës shkencore “Doktor” me një shumicë të cilësuar (katër nga pesë anëtarë të tij) ku vota kundër ose mendimi paralel duhet të argumentohet. Komisioni Doktoratures i përcjell drejtuesit të njësisë kryesore vendimin e tij për vijimin e mëtejshëm të procedurave, në përputhje me legjislacionin në fuqi.
10. Komisioni Doktoraturës mund të bëjë propozime konkrete për ndryshimin e rregullores së funksionimit të tij dhe ia përcjell ato Senatit të UST-së për miratimin e tyre përfundimtar.
11. Komisioni Doktoraturës mund të bëjë propozime për ndryshimin e statutit të UST dhe rregullores së tij, për çështjet që kanë të bëjnë me studimet doktorale.
12. Komisioni Doktoraturës merr vendime dhe i bën ato publike në përputhje me legjislacionin në fuqi.
13. Komisioni Doktoraturës trajton ankimimet që bëhen nga aplikantët dhe studentët e doktoraturës në lidhje me procedurat e ndjekura dhe vendimmarrjet përkatëse. Në çdo rast ankimuesit i kthehet përgjigje zyrtare në përputhje me Manualin për procedurat për aplikimin dhe pranimin në ciklin e tretë të studimeve Doktorate në UST.
14. Drejtuesi i Komisionit të Doktoraturës kryen këto detyra:
 - a. drejton mbledhjet e Komisionit;
 - b. organizon punën e Komisionit për ndjekjen dhe monitorimin në vazhdimësi të procesit të doktoraturave;
 - c. organizon punën për trajtimin dhe zgjidhjen e ankesave në lidhje me procesin e doktoraturave;
 - d. Informon në mënyrë periodike drejtuesit e njësisë bazë dhe të njësisë kryesore për problematikat që janë konstatuar.
15. Komisioni Doktoraturës ka një **Koordinator** të programit të doktoraturës i cili propozohet dhe miratohet nga drejtuesi i njësisë kryesore dhe Rektori i UST-së.

16. Koordinator i Programit të Doktoraturës ka këto detyra:
 - a. administron dokumentacionin e Komisionit të Doktoraturës;
 - b. mban minutat e mbledhjeve dhe zbardh vendimet e Komisionit të Doktoraturës;
 - c. përcjell vendimet e Komisionit tek njësitë bazë dhe kryesore të UST-së;
 - d. kryen çdo detyrë tjetër që i ngarkon rregullorja e studimeve të ciklit të tretë në UST, si dhe detyra të ngarkuara nga Komisioni Doktoraturës brenda fushës së aktivitetit të tij.
17. Mënyra dhe masa e shpërblimit të Komisionit të Doktoraturës dhe Koordinatorit të Programit të Doktoratës miratohen nga Bordi i Administrimit, me propozimin e Senatit Akademik të UST-së.
18. Mbi këtë rregullore bazë, Komisionet e Doktoraturës të njërive kryesore, mbështetur në specifikat e tyre, mund të hartojnë kërkesa shtesë, të cilat miratohen nga Senati Akademik i UST-së.
19. Rregullorja e Komisionit të Doktoratës hyn në fuqi me miratimin në Senatin Akademik të UST-së.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I SPORTEVE TË TIRANËS
SENATI AKADEMIK

**MANUAL
PËR PROCEDURAT PËR APLIKIMIN
DHE PRANIMIN NË CIKLIN E TRETË
TË STUDIMEVE “DOKTORATË” NË
UNIVERSITETIN E SPORTEVE TË
TIRANËS**

MIRATOHET

Prof.Dr. Agron KASA
Kryetari i Senatit Akademik të UST

Miratuar me Vendim Nr. _____, datë _____.2022
të Senatit Akademik të Universitetit të Sporteve të Tiranës

Përmbajtja

- i.** Tabela 1. Lista e personave të cilëve iu dorëzohet botimi/rishikimi i procedurës
- ii.** Tabela 2. Shpjegime dhe shkurtime të termave të përdorur në procedurën e formalizuar
- iii.** Tabela 3. Shkurtime

1. Përmbajtja e procedurës

- 1.1 Qëllimi i procedurës
- 1.2 Fusha e zbatimit të procedurës
- 1.3 Baza Ligjore

2. Përshkrimi i procedurës

- 2.1 Shpallja e njoftimit për hapjen e pranimeve në studimet e doktoratës
- 2.2 Aplikanti për studimet e doktoratës
- 2.3 Vlerësimi, renditja dhe përzgjedhja e kandidatëve
- 2.4 Regjistrimi i kandidatëve fitues

3. Aneksi 1

Dokumentacioni për aplikimin për regjistrim në studimet e ciklit të tretë “Doktoratë”
(Përmbajtja e dosjes individuale)

4. Aneksi 2

Kriteret e përgjithshme të pranimit të kandidatëve në studimet e ciklit të tretë “Doktoratë”

5. Aneksi 3

Formular për propozimin e temës kërkimore shkencore të kandidatit për student në ciklin e tretë të Studimeve të Doktoraturës

i. Tabela 1. Lista e personave të cilëve iu dorëzohet botimi/rishikimi i procedurës

Qëllimi i shpërndarjes	Mënyra e shpërndarjes	Kpoje Nr.	Struktura	Fuksioni	Emër/ Mbiemër	Data e shpërnda.	Shënime
Faktim dhe aplikim	Ekzemplari origjinal	1	Eprori	Zv. Rektori për Kërkimin Shkencor			
Faktim dhe aplikim	Ekzemplari origjinal	1	Instituti i Kërkimit Shkencor të Sportit	Drejtori			
Faktim, aplikim, zbatim dhe arkivim	Ekzemplari origjinal, në format elektronik dhe hard copy	2	Fakulteti i Shkencave të Lëvizjes	Dekani			
		2	Fakulteti i Veprimtarisë Fizike dhe Rekreacionit	Dekani			
		2	Fakulteti i Shkencave të Rehabilitimit	Dekani			
Arkivim	Ekzemplar origjinal	1	Arkiva e UST-së	Përgjegjësi i Sektorit të Protokollit dhe Arkivës			
Informim	Ekzemplar në formë elektronike	1	UST	Të gjithë			

ii. Tabela 2. Shpjegime dhe shkurtime të termave të përdorur në procedurën e formalizuar

Nr.	Termi	Shpjegimi
1	Kërkim Shkencor	Puna krijuese e ndërmarrë dhe e realizuar në mënyrë sistematike, që ka për qëllim shtimin dhe zhvillimin e njohurive shkencore.
2	Grada Shkencore “Doktor”	Gradë shkencore, e cila jepet nga universitetet dhe e cila në shumicën e vendeve, është një gradë hulumtuese, kërkimore dhe shkencore. Grada shkencore “Doktor” fitohet pas mbrojtjes me sukses të tezës së disertacionit, në përfundim të studimeve të doktoratës në fushën e arsimit të lartë dhe kërkimit shkencor, sipas kriterëve dhe brenda afateve të përcaktuara nga legjislacioni për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor.
3	Programi i Studimit	“Programi i studimit” është një tërësi veprimtarish akademike dhe/ose kërkimore shkencore, përfundimi me sukses i të cilave i jep të drejtën studentit të pajiset me një certifikatë, diplomë ose gradë shkencore prej institucionit të arsimit të lartë që e ofron atë, në varësi të llojit të programit të studimit.
4	Cikli i Tretë i Studimeve	Cikli i tretë i studimeve përfshin programet e studimeve “Master ekzekutiv”, programet e studimeve specializuese afatgjata, si dhe studimet e doktoratës, referuar nivelit 8 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve.
5	Studimet e Doktoratës	Studimet e doktoratës ndërtohen mbi programe individuale për aftësim të pavarur të kandidatëve në kërkimin shkencor në fushat e përcaktuara nga njësia bazë ose njësia kryesore. Ato kanë në themel kërkimin shkencor dhe veprimtaritë krijuese. Studimet e doktoratës zgjasin jo më pak se tre vite akademike dhe jo më shumë se pesë vite akademike. Në përfundim të studimeve të doktoratës lëshohet diploma e gradës shkencore “Doktor”. Institucionet e arsimit të lartë vendosin kriteret për vlerësimin e pjesëshëm dhe vjetor të ecurisë së kandidatëve si dhe vazhdimin e punës për zhvillimin e projektit kërkimor.
6	Komisioni i Doktoratës	Në Statutin e UST, miratuar nga Ministria e Arsimit Sportit , datë 25.01.2022, Komisioni i përhershëm për dhënien e gradës shkencore “Doktor” në Universitetin e Sporteve të Tiranës mban emërtimin “Komisioni i Doktorates”.

iii. Tabela 3. Shkurtime

Shkurtimi	Termi i Shkurtuar
UST	Universiteti i Sporteve të Tiranës
IKSHS	Instituti i Kërkimit Shkencor të Sportit
KD	Komisioni i Doktoratës

1. Përmbajtja e procedurës

1.1 Qëllimi i procedurës

Kjo procedure ka si qëllim organizimin dhe administrimin e procesit nga regjistrimi i aplikantit deri në përfundimin regjistrimit të tij në Programin e Studimit të Doktoraturës.

1.2 Fusha e zbatimit të procedurës

Procedura për aplikimin dhe pranimin në ciklin e tretë të studimeve “Doktoratë”, aplikohet në njësitë bazë dhe njësitë kryesore.

1.3 Baza Ligjore

- Ligji Nr. 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”;
- VKM 112, datë 23.02.2018, “Për përcaktimin e kriterëve për fitimin e Gradës Shkencore ‘Doktor’ dhe standardeve shtetërore për fitimin e titujve akademikë ‘Profesor i Asociuar’ dhe ‘Profesor’”; i ndryshuar me VKM 808, datë 11.12.2019;
- Udhëzimin Nr. 1, datë 14.1.2020 dhe Udhëzimin Nr. 7, datë 31.3.2021, për “Dokumentacionin dhe procedurat për hapjen, riorganizimin dhe mbylljen e Institucionit të Arsimit të Lartë, degëve të tyre, njësite kryesore dhe programeve të studimit si dhe për ndarjen ose bashkimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë”;
- Statuti i Universitetit të Sporteve të Tiranës;
- Rregullore e Studimeve të Doktoratës së Universitetit të Sporteve të Tiranës;
- Rregullore e Komisionit të Përhershëm për dhënien e gradës shkencore “Doktor” e Universitetit të Sporteve të Tiranës dhe manuali përkatës;
- Rregullore e programeve të studimit të Doktoratës.

2. Përshkrimi i procedurës

2.1 Shpallja e njoftimit për hapjen e pranimeve në studimet e doktoratës

- Pas shpalljes së rezultateve të verifikimit të hapjes/riorganizimit të studimeve të doktoratës dhe miratimit të kuotave për vitin akademik nga MAS, Rektori i UST-së, brenda 15 ditëve të punës, nxjerr urdhërin për hapjen e pranimeve në studimet e doktoratës. Në urdhërin e Rektorit specifikohet hapja e aplikimeve në studimet e doktoratës në UST si dhe afatet kohore, brenda të cilave do të kryhen këto aplikime.
- Drejtuesi i njesisë kryesore brenda 5 ditë pune pas daljes së udhërit të Rektorit, përgatit dhe shpall njoftimin për hapjen e pranimeve në studimet e doktoratës, në faqen zyrtare të UST-së dhe ja përcjell në rrugë zyrtare (Hard Copy ose elektronike) njësite kryesore të UST-së nëpërmjet Koordinatorit të Programit të Studimit.

Njoftimi përmban këto informacione:

- a. Fushat e studimeve të doktoratës (emërtimi duhet të jetë sipas Udhërit të MAS për hapje/riorganizim të shkollës së doktoratës);
- b. Kuotat e doktoratës në çdo fushë (kuotat duhet të jenë sipas përcaktimit në shkresën përcjellëse – Urdhër për njohje dhe zbatim të MAS);
- c. Dokumentacioni i nevojshëm për aplikim (Aneks 1);

- d. Afati për paraqitjen e aplikimit (në zbatim të Urdhërit të Rektorit të UST-së për hapjen e aplikimeve);
- e. Kriteret e përgjithshme të pranimit (Aneks 2). Nëse njësia kryesore/njësia bazë ka formuluar kritere specifike, atëherë ajo i përfshin edhe këto kritere specifike dhe skemen e vlerësimit të kandidatëve. Shpallja behet në faqen zyrtare të UST-se dhe në mjediset e saj.

2.2 Aplikanti për studimet e doktoratës

- Aplikanti për studimet e doktoratës, brenda afatit të përcaktuar në urdhërin e Rektorit të UST-së, aplikon për t'u regjistruar në studimet e doktoratës, me dosjen individuale. Dosja individuale duhet të përmbajë dokumentat e dhëna sipas Aneks 1 dhe Aneksit 3 të kësaj procedure si dhe tarifën e aplikimit dhe të regjistrimit.
- Aplikanti për studimet e doktoratës, pasi plotëson dosjen individuale në bashkëpunim me drejtuesin e tij shkencor, e dorëzon atë në sekretarinë mësimore e njësisë kryesore përgjegjëse për studimet e doktoratës.

2.3 Vlerësimi, renditja dhe përzgjedhja e kandidatëve

- Drejtuesi i njësisë kryesore, përcjell brenda 2 (dy) ditë pune nga mbyllja e aplikimeve dosjet e aplikimit tek drejtuesi i njësisë bazë.
- Njësia bazë përgjegjëse për studimet e doktoratës me propozim të drejtuesit të saj, brenda 2 (dy) ditë pune nga data e marrjes së aplikimeve nga ana e drejtuesit të njësisë kryesore, ngrë komisionin "Ad-hoc" me tre deri në pesë anëtarë, kryetari i të cilit është drejtuesi i projektit kërkimor fitues të Programit Doktorat. Anëtarët e këtij komisioni janë anëtarë të njësisë bazë, të kategorisë "Profesor" ose në mungesë të tyre të kategorisë "Lektor", specialistë të fushës përkatëse të kërkimit ose të fushave të përafërta.
- Drejtuesi i njësisë bazë ja përcjell propozimin për ngritjen e komisionit "Ad-hoc" brenda 1 (një) ditë pune, për miratim drejtuesit të njësisë kryesore.
- Drejtuesi i njësisë kryesore brenda 2 (dy) ditë pune miraton komisionit "Ad-hoc" të propozuar nga njësia bazë.
- Komisioni "Ad-hoc" mblidhet për të bërë vlerësimin dhe renditjen e kandidatëve, mbështetur në dosjet e aplikimit, jo më vonë se 2 javë pas mbylljes së aplikimit të kandidatëve.
- Pas kësaj, komisioni "Ad-hoc" brenda 5 (pesë) ditë pune, përcjell listën me renditjen paraprake të kandidatëve dhe dosjet e tyre, drejtuesit të njësisë kryesore.
- Drejtuesi i njësisë kryesore brenda 2 (dy) ditë pune i përcjell listën me renditjen paraprake të kandidatëve dhe dosjet e tyre për miratim Komisionit të Doktoraturës.
- KD, brenda 5 (pesë) ditë pune shqyrton dhe vlerëson dosjen e çdo kandidati që i paraqet njësia bazë, cakton të paktën një relator për shqyrtimin e dosjes, therret në seancë dëgjimore kandidatet së bashku me udhëheqesit shkencor. Mbështetur në raportin e lëshuar dhe në gjykimin e anëtarëve të tij, KD miraton ose jo propozimin e njësisë bazë për kandidatet dhe drejtuesit shkencor të tyre. Menjëherë pas kësaj, KD shpall listën paraprake të kandidatëve fitues me drejtuesit shkencorë përkatës.
- Kandidati/ja, brenda 2 (dy) ditë pune nga shpallja e listës paraprake të kandidatëve fitues, ka të drejtë të ankimojë me shkrim procedurën e vlerësimit të tij/saj, pranë sekretarisë mësimore të njësisë kryesore përkatëse.
- KD, brenda 3 (tre) ditë pune nga afati i fundit i ankimimit, trajton ankimimet dhe i kthen përgjigje zyrtare të argumentuar ankimuesit, në përputhje me procedurat administrative përkatëse.
- Pas kësaj, KD, brenda 2 (dy) ditë pune, shpall dhe publikon renditjen përfundimtare të kandidatëve fitues në faqen zyrtare të njësisë kryesore përkatëse si dhe në ambientet e saj.

Njëkohësisht, KD përcjell në mënyrë zyrtare listën përfundimtare të kandidatëve të pranuar në studimet e doktoratës pranë Rektoratit të UST-së.

2.4 Regjistrimi i kandidatëve fitues

- Kandidatët fitues regjistrohen në sekretarinë mësimore të njësisë kryesore përkatëse të studimeve të doktoratës, brenda 2 (dy) javëve nga data e shpalljes së listës përfundimtare të kandidatëve fitues.
- Në rast se një kandidat tërhiqet ose nuk regjistrohet brenda afatit të përcaktuar, atëherë ai e humbet të drejtën e vazhimit të studimeve të doktoratës dhe në vend të tij, brenda një afati 5 (pesë) ditë pune, regjistrohet kandidati vijues në listën përfundimtare.
- Dokumentacioni i aplikimit të kandidatëve fitues depozitohet në sekretarinë e njësisë kryesore dhe pasurohet gradualisht me të gjithë dokumentacionin që provon ecurinë e doktorantit.
- Kandidatëve jofitues, me kërkesën e tyre, ju kthehet dosja individuale me dokumentet e aplikimit, brenda 2 (dy) javëve, pas paraqitjes së kërkesës me shkrim.

Aneksi 1

DOKUMENTACIONI PËR APLIKIMIN PËR REGJISTRIM NË STUDIMET E CIKLIT TË TRETË “DOKTORATË”

(Përmbajtja e Dosjes Individuale)

1. Kërkesën e kandidatit drejtuar njësisë bazë, që është përgjegjëse për organizimin dhe administrimin e studimeve të doktoratës, ku të përfshihet fusha e studimit të doktoratës, që kërkon të ndjekë dhe drejtuesi shkencor;
2. Deklaratë e drejtuesit shkencor për udhëheqjen e studimit të doktoratës, në fushën e përzgjedhur;
3. Propozim për temën e kërkimit/metodologjinë/pritshmëritë etj., firmosur nga udhëheqësi sipas Aneksit 3;
4. Letër motivimi;
5. CV personale;
6. Lista e punimeve shkencore të dokumentuara, nëse ka të tilla;
7. Kopje të noterizuar të diplomave të ciklit të parë dhe të ciklit të dytë “Master i Shkencave”, të shoqëruara me suplementet e diplomave përkatëse. Diplomat e fituara jashtë vendit duhet të shoqërohen me vërtetimin e njohjes/ekuivalentimit nga ministria përgjegjëse për arsimin;
8. Kopje të noterizuar të diplomave të ciklit të tretë “Master ekzekutiv“, diplomë specializimi, ose të diplomave ekuivalente me to, shoqëruar me suplementin e diplomës, nëse kandidati ka të tilla;
9. Fotokopje të kartës së indentitetit/pasaportës;
10. Dy fotografi;
11. Dy rekomandime nga persona të kategorisë “Profesor” ku njëri prej të cilëve duhet të mbulojë fushën përkatëse të kërkimit shkencor;
12. Vetëdeklarim ku kandidati pranon të shlyejë të gjitha detyrimet financiare të studimeve të doktoratës, sipas përcaktimeve të bëra nga UST;
13. Dëshmi të gjuhës së huaj, sipas legjislacionit në fuqi;
14. Vërtetim nga qendra e punës, nëse është i punësuar në institucione të tjera akademike;
15. Mandat pagese për tarifën e aplikimit.

***Shënim: Dosja duhet të ketë inventar dorëzimi, i cili firmoset në momentin e dorëzimit nga kandidati aplikant dhe sekretaria e njësisë kryesore.**

Aneksi 2

KRITERET E PËRGJITHSHME TË PRANIMIT TË KANDIDATËVE NË STUDIMET E CIKLIT TË TRETË “DOKTORATË”

1. Diplomë universitare “Master i shkencave” në UST;
2. Diplomë e sistemit të vjetër 4-vjeçar në UST;
3. Master i Shkencave ose DND të fituara në institucione të tjera të arsimit të lartë, brenda ose jashtë vendit, në përputhje me përcaktimet e bëra në programin e studimeve të doktoratës ose në rregulloren e saj;
4. Diplomat e fituara jashtë vendit duhet të ekuivalentohen përpara aplikimit, sipas akteve ligjore në fuqi të ministrisë përgjegjëse për arsimin;
5. Mesatare të ponderuar të notave në ciklin e parë të studimeve (diploma Bachelor/DNP) dhe në ciklin e dytë të studimeve Master i Shkencave/DND, të programeve të integruara të nivelit të dytë dhe të sistemit të vjetër 4-vjeçar, jo më të vogël se 8 (tetë), ose jo më pak se 80 % e pikëve totale;
6. Njohje të njërës prej pesë gjuhëve të huaja si: anglisht, frëngjisht, gjermanisht, italisht, spanjisht, të vërtetuar përmes testeve të njohura ndërkombëtare në nivelin e miratuar nga SA i UST, në përputhje me kornizën ligjore në fuqi;
7. Nëse kandidati ka fituar një diplomë të një programi studimi të kryer në një nga pesë gjuhët e përmendura më sipër, diploma e fituar i shërben si dëshmi për plotësimin e kriterit të gjuhës së huaj.
8. Vetëm kandidatet të cilët plotësojnë të gjitha kriteret e mesiperme , kualifikohen për fazën tjetër të vlerësimit.

Aneksi 3

FORMULAR PËR PROPOZIMIN E TEMËS KËRKIMORE SHKENCORE TË KANDIDATIT PËR STUDENT NË CIKLIN E TRETË TË STUDIMEVE TË DOKTORATURËS

Kandidati/Studenti-ja:	
Viti Akademik:	

Udhëheqësi Shkencor:	
-----------------------------	--

Tema e Projektit Kërkimor Shkencor

<i>Fusha e Studimit</i>

<i>Nën-fusha e Studimit</i>

<i>Lloji i Studimit</i>

<i>Kohëzgjatja e Projektit Kërkimor</i>	<i>Data e Fillimit të Projektit Kërkimor</i>

<i>Abstrakti</i> (jo më shumë se 500 fjalë)

<i>Identifikimi i Problemit dhe Rëndësia e Zgjidhjes së tij</i> (duhet të shprehet qartë riveiw e literaturë mbështetëse për projektin dhe rëndësia e studimit, jo më shumë se 1000 fjalë)

<i>Qëllimi</i> (jo më shumë se 150 fjalë)

Hipoteza-at (qartë dhe sa më konçize)

Objektivat e Projektit Kërkimor (objektivat duhet të jenë të qarta dhe sa më konçize)

Risia e Projektit (origjinaliteti dhe veçantia e projektit duhet të marrin vëmendje të veçantë, jo më shumë 250 fjalë)

Metodologjia (të sqarohet metodat që do të përdoren gjatë punës kërkimore me referencat përkatëse nga literatura, ato duhet të jenë të qarta dhe sa më konçize)

Rezultatet e Pritshme (me rëndësi të veçantë është të përcaktohet qartë kontributi i kërkimit në përputhje me: fushën dhe nën-fushën e programit të doktoraturës në fjalë, jo më shumë se 500 fjalë)

Përfituesit Direkt (me pika, sa më konçiz)	Përfituesit Indirekt (me pika, sa më konçiz)

Si do të Bëhen të Njohura Rezultatet/Produkti (në veçanti të sqarohet kur dhe si do të realizohen dy botimet e detyrueshme për projektin kërkimor në harkun e 3 vitetve të studimit të doktoraturës, jo më shumë 250 fjalë)

Grafiku i Plani i Punës së Projektit Shkencor për Vitin e I												
(Plani i punës do të zhvillohet mbi bazën e kapitujve të cilat duhet të përshkruhen në tabelën e dhënë. Specifikoni kohën përkatëse me X ose duke e mbushur me ngjyrë katrorin/rët përkatës, ndërsa M i referohet muajve)												
Koha	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12
Përshkrimi i Kapitujve që do të Realizohen	M	M	M	M	M	M	M	M	M	M	M	M
1-												
2-												
3-												
--												

Grafiku i Plani i Punës së Projektit Shkencor për Vitin e II

(Plani i punës do të zhvillohet mbi bazën e kapitujve të cilat duhet të përshkruhen në tabelën e dhënë. Specifikoni kohën përkatëse me X ose duke e mbushur me ngjyrë katrorin/rët përkatës, ndërsa M i referohet muajve)

Koha	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12
Përshkrimi i Kapitujve që do të Realizohen	M	M	M	M	M	M	M	M	M	M	M	M
1-												
2-												
3-												
--												

Grafiku i Plani i Punës së Projektit Shkencor për Vitin e III

(Plani i punës do të zhvillohet mbi bazën e kapitujve të cilat duhet të përshkruhen në tabelën e dhënë. Specifikoni kohën përkatëse me X ose duke e mbushur me ngjyrë katrorin/rët përkatës, ndërsa M i referohet muajve)

Koha	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12
Përshkrimi i Kapitujve që do të Realizohen	M	M	M	M	M	M	M	M	M	M	M	M
1-												
2-												
3-												
--												

Buxheti i Projektit Kërkimor Shkencor

(sipas zërave dhe në total – në lekë, me pika dhe sa më konçiz)

--

Stdenti-ja Kandidat/Msc. Emri, Mbiemri	Datë	Nënshkrimi

Udhëheqësi Shkencor/Titulli Emri, Mbiemri	Datë	Nënshkrimi